

Mbi Auditimin e Ushtruar në Degën e Doganës, Qafë-Botë, Sarandë

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Degën e Doganës, Qafë-Botë, Sarandë, me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit doganor” për periudhën viti 2012-2013 si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 73, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr.321/9, datë 30.06.2014 dhe nr. 321/8, datë 30.06.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar znj. Elisa Spiropali, Drejtor i Përgjithshëm i Doganave, Tiranë dhe znj. Raimonda Gjoni, Kryetare e Degës Doganës, Qafë-Botë, Sarandë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A-MASA ORGANIZATIVE

1. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë të marrë masa të plota, për ndjekjen e realizimit të të ardhurave doganore nga një punonjës i caktuar, të cilat do të shërbejnë për një analizë më të shpejtë e të argumentuar sipas sektorëve dhe njësive përkatëse organizative.

2. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë, të marrë masa që të mos ndërpriten ritmet për vazhdimin e rikuperimit të borxhit doganor të mbetur pa rikuperuar në vlerën prej *11,078,811 lekë*, e rekomanduar nga KLSH në auditimin e mëparshëm duke përdorur të gjitha rrugët dhe mjetet ligjore.

3. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë të marrë masa që praktikant doganore, të pranuar me transaksion në përcaktimin e vlerës për qëllime doganore, të mbështeten me procesverbale vlerësimi të indikatorëve në zbatim të neneve 285, 286, 287 e vijim të Kodit Doganor, si dhe të udhëzimit nr. 25, datë 13.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes më të dhëna të disponueshme dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre” pika 6, në të cilën thuhet: *“Përcaktimi i vlerës së artikullit bazuar në pikat e mësipërme, gjithmonë duhet të shoqërohet nga një procesverbal sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi, ku duhet të plotësohen indikatorët e kontrolluar...”* si dhe në zbatim të Kodit Doganor nenet 34 “vlera e transaktuar” dhe 35/a “vlera e mallrave identike”.

4. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë të marrë masa për ndalimin e menjëhershëm të përdorimit të dokumenteve shoqëruese të praktikave doganore që paraqiten për zhdoganim nga operatorët ekonomik dhe pranohen për vlerësim nga administrata doganore, në formën dokumente fotokopje të tilla si fatura e shitjes, CMR, deklarata e eksportit, certifikata e origjinës, lista e paketimit në raste të veçanta edhe Euro 1, veprime këto që bien në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Dispozitat Zbatuese” dhe udhëzimi nr. 25, datë 30.11.2007, i Ministrisë të Financave.

5. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë të nxjerrë menjëherë urdhrin e brendshëm për funksionimin e Komisionit të Vlerësimit doganor, për të vlerësuar mallrat për të cilët nuk kanë të dhëna të disponueshme të dërguar nga DPD, si dhe për mallrat e përdorura.

6. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë të marrë masa për të kryer plotësimin e dosjeve dokumentare të të gjitha subjekteve që operojnë me akcizë.

7. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë për 18 subjekte që rezultojnë me borxh doganor në një vlerë prej 11,330,880 lekë të marrë masa; për të kërkuar informacion në Bankat e nivelit të dytë për rikuperimin e borxhit; të kërkojë informacion në zyrat e regjistrimit të pasurive të patundshme për pronësi mbi pasuritë që posedojnë subjektet me borxh doganor; dhe të fillojë procedimin Gjyqësor për të nxjerrë Urdhrin Ekzekutiv.

8. Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë të marrë masa për nxjerrjen e vendimit për rikuperimin me forcë të borxhit doganor nga subjekti [REDAKTUAR] në zbatim të vendimit nr. 39 datë 21.10.2013 për detyrimin doganor në vlerën 520,503 lekë.

B. MASA PER SHPERBLIM DEMI

Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë, të kryejë kontabilizimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerë prej 9,360,804 lekë si më poshtë;

1. Vlera prej 1,606,711 lekë nga 13 subjekte sipas pasqyrës nr. 1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe trajtimit në faqet 19-42 të Raportit, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalteteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, në 42 raste, për vitin 2012.

2. Vlera prej 1,709,713 lekë, për 7 subjekte sipas pasqyrës nr. 2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe trajtimit në faqet 31-42 të Raportit, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalteteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, në 30 raste, për vitin 2013.

3. Vlera prej 222,607 lekë, për subjektin [REDAKTUAR], sipas pasqyrës nr. 3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe trajtimit në faqet 26-27 të Raportit, për mos llogaritje dhe mos arkëtim të detyrimeve doganore dhe penalteteve sipas KD, për pranim të vlerës së transaksionit jo në përputhje me kërkesat dhe kriteret ligjore, në 30 raste, për vitin 2013.

4. Vlera prej 79,689 lekë për 12 subjekte sipas pasqyrës nr. 4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe trajtimit në faqet 40-42 të Raportit, për llogaritjen e gabuar të rentës minerare për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2013 për disa artikuj në kundërshtim me legjislacionin minerar.

5. Vlera prej 873,855 lekë, në 13 raste, për 12 subjekte, sipas pasqyrës nr. 5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe trajtimit në faqet 57-62 të Raportit. Për mos aplikimin e sanksioneve në përputhje me referencat ligjore të shkelura e të cituara në vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor kompetent për periudhën 1 janar 2012 deri 31 dhjetor 2013.

6. Vlera prej **4 868 229 lekë** nga Subjekti [REDAKTUAR], trajtuar në faqet 42-45 të Raportit. Për mos llogaritje e arkëtim të detyrimeve doganore e mos aplikim saksionesh në përputhje e zbatim të neneve, 160 e 273 të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH”.

C. MASA ADMINISTRATIVE

Dega e Doganës Qafë Botë, Sarandë, të analizojë e të nxjerrë përgjegjësitë administrative për shkeljet e legjislacionit në fuqi të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe duke i ndëshkuar subjektet me gjobë si më poshtë;

1. Në bashkëpunim me kontrollin a-posterior zyra e regjimeve doganore të marrë masa lidhur me subjektet që administrojnë magazinë fiskale dhe kanë shkelur kërkesat ligjore të konstatuara nga auditimi mbi zbatimin e ligjit nr. 61, datë 24.05.2012 “Për Akcizat në RSH”, për të cilat autoriteti doganor kompetent nuk ka aplikuar gjoba për **6 subjektet** [REDAKTUAR] në vlerë 50,000 lekë/sejçili, **gjithsej në vlerë 350,000 lekë**.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë; Drejtoreshës së Përgjithshme të Doganave dhe Kryetares së Degës Doganës, Qafë Botë Sarandë, që në vlerësimin e shkeljeve të mëposhtme të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda e shumë të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhëroje fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse disiplinore, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për nëpunësit civil të Degës Doganës, Qafë Botë Sarandë, **10 punonjes** si më poshtë:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës Operacional në Qafë Botë, për 39 raste.
2. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës Operacional në Qafë Botë për 24 raste.
3. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjës Operacional në Sarandë, në cilësinë e ish-Aposterior, Jurist për 9 raste.
4. [REDAKTUAR] me detyrë doganier Klasifikim/vlerësimi në Sarandë për 15 raste.
5. [REDAKTUAR] me detyrë doganier regjimesh, në cilësinë e ish-doganier Klasifikim/vlerësimi në Sarandë, për 3 raste
6. [REDAKTUAR] me detyrë doganier Klasifikim/vlerësimi në Qafë Botë, Sarandë për 13 raste
7. [REDAKTUAR] me detyrë doganier Klasifikim/vlerësimi në Qafë Botë, Sarandë për 3 raste
8. [REDAKTUAR] me detyrë doganier Klasifikim/vlerësimi dhe doganier regjimesh ekonomike në Qafë Botë, Sarandë, për 7 raste.
9. [REDAKTUAR] i transferuar me shkresën nr. 7427, datë 24.04.2013, në cilësinë e doganier Klasifikim/vlerësimi dhe doganier regjimesh ekonomike në Qafë Botë Sarandë, për 15 raste.
10. [REDAKTUAR] Aposterior, Jurist në Qafë Botë Sarandë.

-Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale, pasi është vepruar në kundërshtim me kërkesat e neneve 34-40 të KD, të VKM-së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese

të KD” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, me ndryshime, sipas trajtimit në faqet 19-42 në Raportin Përfundimtar të Auditimit .

Është vepruar në kundërshtim me kërkesat e neneve 34-40 dhe 160 të KD, të VKM-së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD” i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 “Për vlerën doganore”, me ndryshime, sipas trajtimit në faqet 19-45 në Raportin Përfundimtar të Auditimit .

- Është vepruar në kundërshtim me kërkesat e neneve 18, 245 dhe 261 të KD, të VKM-së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD”, si dhe Udhëzimit nr. 4, date 04/08/2006 “Për Zbatimin Praktik të Procedurës së Evidentimit, Kontabilizimit dhe Vjeljes së Borxhit Doganor”.

Shënim: Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, për **3 ish-punonjës** nuk rekomandohet masë pasi nuk janë më në marrëdhënie pune me institucionin.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë Vendim ngarkohet, Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Auditimi u krye nga audituesit Artan Mirashi, p/grupi, Aqif Klosi, Taulant Stërmasi, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

Dega e Doganës, Qafë-Botë, Sarandë me shkresën nr. 321/10, datë 01.08.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se, është hartuar plani i masave për zbatimin e rekomandimeve të lena nga KLSH. Janë marrë masat përkatëse për zbatimin e të gjitha masave organizative të propozuara, si dhe janë vlerësuar masat për shpërblim dëmi në shumën **9,360,804 lekë** dhe janë nxjerrë vendimet përkatëse. Për Masat disiplinore po bashkëpunohet me DPD për vlerësimin e personelit doganor dhe klasifikimin e tyre për fillimin e procedurave dhe dhënien e masave disiplinore.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Punoi: Albana AGOLLI